



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

RAPORTI VJETOR 2022

Lista e shkurtesave

DK	Dogana e Kosovës
AEO	Operatorët e Autorizuar Ekonomik
CEFTA	Marrëveshja e tregtisë së lirë e Evropës Qendrore
DP	Drejtori i Përgjithshëm
DDR	Departamentet Doganore Rajonale
DUD	Dokumenti Unik Doganor
DPI	E drejta e Pronësisë Intelektuale
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MSA	Marrëveshja e stabilizim asocimit
UE	Unioni European
BK	Buxheti i Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MPBAP	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
SSP	Spektori i Standardeve Profesionale
SEEMS	Sistemi i Menaxhimit i të dhënave për Evropën Jug-lindore
PMNE	Procedurat Doganore me ndikim ekonomik
OBD	Organizata Botërore e Doganave
PT	Plani i Trajnimeve
ST	Spektori i trajnimeve
AKK	Agjencioni kundër korrupsionit
KD	Komisioni Disiplinor
GJTH	Gjykata themelore
SPPOD	Spektori për Pajtuëshmërinë e Procedurave Operative Doganore
LPP,LQP,LMP,PTI	Procedural e ndërlidhura me pakot fiskale
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit
LES	Law Enforcement Information System
QRKS	Qeveria e Republikës së Kosovës

Përgatitur nga:

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Kopjet e tjera të këtij dokumenti mund të merren nga:

Zyra e shtypit, Drejtoria e Doganës, Prishtinë - Republika e Kosovës. Tel:

038 540 796 Fax: 038 540 065 E-mail: info@dogana-ks.org

Raporti është gjithashtu në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të Doganës:

www.dogana-ks.org

Prill, 2023

VITI 2021/2022 – STATISTIKAT KRYESORE

Mbledhja e të Hyrave €'000	2021	2022	ndryshimi në %
Të hyrat totale	1.370	1,531.31	11.2%
Taksa doganore	123.8	132,66	6.46%
Akciza	501.1	517,26	3.2%
TVSH-ja	745.03	875,38	17.2%
Buxheti dhe Shpenzimet			
Buxheti vjetor	10.4	9.8	-6.1%
Paga dhe mëditje	5.8	5.8	/
Mallra dhe shërbime	2.09	2.09	/
Komunali	0.64	0.64	/
Shpenzime Kapitale	1.87	1.87	/
Kthimi i investimit (indikator)			
Shpenzimet/të hyrat	0.008	0.006	/
Vlera e mallrave në import €'000			
Vlera e Importit (IM4)	4.64 miliard	5.60 miliard	20.5%
Pesha neto në Import (IM4)	5.5 milion kg	4.7 milion kg	-14.53%
Vlera e mallrave në eksport €'000			
Vlera e Eksportit (EX1)	712.7 milion €	869.6 milion €	22%
Pesha neto në Eksport (EX1)	986.5 milion kg	837.4 milion kg	-17%
Statistikat e operimeve			
Numri i ankesave	805	914	11.9%
Numri i kundërvajtjeve	1714	1795	1.1%
Kallëzimet penale	84	69	-22%
Vlera e shmangieve sipas kallëzimeve penale	2.7 milion €	2.8 milion €	3.5%
Vlera e mallrave te sekuestruara	4.1 milion €	6.2 milion €	52%
Gjoha	1.3 milion €	1.8 milion €	35%
Vlera e deklaruar vullnetare	93%	94%	/

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Bazuar në mandatin dhe misionin e saj, Dogana e Kosovës vazhdon ti tejkaloj projeksionet përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës si në mbledhjen e të hyrave për buxhetin e shtetit po ashtu edhe në mbrojtjen e shoqërisë nga mallrat e ndaluara, mallrat e rrezikshme dhe mallra me përdorim të dylshëm. Krejt këto rezultate i atribuohen përkushtimit të lartë dhe proaktiv të gjithë punonjësve të Doganës së Kosovës e cila si strukturë menaxhohet nga profesionistë dhe zyrtarë me përvojë, integritet dhe profesionalizëm. Në fushën e të hyrave deri në fund të vitit ne do të mbledhim rreth 1 miliard e 525 milion Euro, që është hera e parë që kalojmë shumën 1.5 miliard, dhe kjo shumë është për rreth 157 milion apo 11.5% më shumë se sa e vitit të kaluar. Kemi kaluar projeksionin e rishikuar të muajit korrik të vitit 2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës rreth 3% apo rreth 50 milion euro. Ky rezultat pa dyshim që është mbresëlënëses duke na bërë neve krenar për shërbimin ndaj shtetit dhe qytetarëve si obligim ligjor dhe i barasvlefshëm në ditët e sotme edhe si akt patriotik i kohës moderne. Andaj sigurisht se është arsye e fortë që të ndjehemi krenar të gjithë ne që kemi dhënë dhe po vazhdojmë të japim kontributin tonë kaq domethënës për vendin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Angazhimi dhe orientimi i kapaciteteve drejt sukseseve sigurisht se burojnë nga udhëheqja profesionale, përmirësimi i proceseve të punës dhe qasjes tonë proaktive me dimension kolektiv të orientuar kah rezultatet.

Disa nga fushat që neve na bëjnë të ndjehemi mire janë:

- Vlera e mallrave të konfiskuara dhe sekuestruara është rritur për 21%, apo në lartësi prej rreth 11 milion €,
- Vlera e gjobave të shqiptuara është rritur për 30 % e që këtë vit është 1.7 milion €, përderisa ndërsa,
- Lartësia e shmangieve të zbuluara dhe të rikuperuara nga vendimet e sektorit të kontrollës pas importit është 4.6 milion €, apo rritje prej 36.6 % krahasuar me vitin 2021.

Në kontest të mbrojtjes së shoqërisë gjithashtu kemi arritur rezultate jazhtëzakonisht të mira .

Drejtoria e Zbatimit të Ligjit-DZL ka proceduar në Prokurori:

- 69 kallëzime penale për shmangie të argumentuara në vlera prej 2.8 milion euro, ndërkaq
- Numri i të arrestuarve është 16 apo 23% më i lartë se në vitin paraprak, ndërkaq
- Në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, fatkeqësisht edhe në këtë vit kemi shënuar rritje të masave të shqiptuara prej 13%, ku këtë vit janë shqiptuar masa në 26 raste disiplinore. Kjo tregon përkushtimin menaxherial për zero tolerancë ndaj veprave të paligjshme.

Rezultate rekorde janë shënuar edhe te zbulimi i mallrave të ndaluara, ku si rezultat i veprimeve parandaluese, qasjes profesionale dhe punës ekipore janë zbuluar në një rast 83.6 kg substancë narkotike heroinë.

Në kontest të bashkëpunimit me autoritetet vendore, DZL së bashku me Policinë e Kosovës kanë zbuluar një 'fermë' të prodhimit ilegal të kanabisit me rreth **10,000 copë** bimë narkotike në vlerë prej rreth **6 milion Euro**, dhe laboratorin në vlerë prej afro 1.5 milion €.

Po ashtu gjatë kontrollit të dërgesës me mallra nga Irani e cila nga kompetentet brenda Doganës është vlerësuar si risk potencial ku dyshohej se në ngarkesë ka substanca narkotike të tretura në qaj, me ç'rast Dogana ka koordinuar veprimet e kontrollit pas importit me Policinë e Kosovës dhe si rezultat është zbuluar operacioni i përpunimit të narkotikëve ku janë konfiskuar afër 70 kg narkotikë dhe janë arrestuar 16 persona të përfshirë.

Ndërsa në kontest të bashkëpunimit ndërkombëtar, Dogana e Kosovës si rezultat i shkëmbimit të informatave me autoritetet turke në Turqi ka arritur ti kontribuoj zbulimit të rreth **108 kg narkotik të llojit HEROINË**, e cila sipas informatave dyshohet se ka pasur destinacion vendin tonë.

Gjithashtu Dogana ka pasur rezultate të theksuara edhe në parandalimin dhe zbulimin e armëve dhe municionit, zbulim të aktiviteteve ilegale të operimit ilegal të pajisjeve për krypto valuta, kartela grafike si dhe rezultate të knaqëshme në mallrat e falsifikuara.

Në kontest të lehtësirave tregtare, Dogana e Kosovës në vitin 2022 po ashtu ka shënuar shumë progres. Me 1 Tetor 2022 kemi hapur për zhdoganim zyrtar doganore në dy portet detare të Shqipërisë në Portin e Durrësit dhe Porto Romano. Sipas matjeve nga Banka Botërore sa përket kohës së pritjes apo kohës së zhdoganimit raportet tregojnë përsheptim të procesit për 36% në import dhe 18% në eksport. Fakt ky që tregon qartë se Dogana e Kosovës ka ndërtuar sisteme kompaktibile dhe që i kontribuojnë lehtësirave tregtare dhe zhdoganimit të shpejtë dhe të sigurtë.

Zhvillime të rëndësishme gjatë këtij viti kemi pasur edhe në reformën e përgjithshme. Me ligjin e përpiluar nga Qeveria për zyrtarët publik, Dogana është përjashtuar nga rregullimi strikt për sektorin publik në përgjithësi, duke ruajtur të drejtën për vet-rregullim të marrëdhënies së punës, për tu përshtatur me rrethanat dhe synimet tona për zhvillim të organizatës, gjë që duhet të mundësoj organizim më efikas dhe më të lehtë të administratës tonë. Gjatë këtij viti 2022 gjithashtu është miratuar ligji për pagat, ku Dogana është specifikuar me aneks që përcakton shkallët e kompensimit sipas pozitive të punës në Doganën e Kosovës, dhe në këtë përcaktim Dogana e Kosovës është vlerësuar në mënyrë korrekte, duke ruajtur trajtimin dinjitoz të zyrtarit doganor. Gjatë këtij viti kemi bërë zhvillime edhe me dy projekte të përkrahura nga zyra e BE dhe GIZ, që synojnë të avancojnë praktikën dhe sistemet tona sipas praktikave bashkëkohore.

Gjithashtu gjatë këtij viti ne kemi përgatitur draft kodin e ri doganor dhe me këtë kod është parashikuar edhe rregullimi i marrëdhënies së punës.

Për të gjitha zhvillimet ne kemi synuar të përfshijmë zyrtarët nga të gjitha pozitat dhe gradat, me qëllim që të kemi gjithë përfshirje dhe pjesëmarrje që e bëjnë procesin më të pasur dhe transparent.

Mekanizmi kredibil pulsi publik që matë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve ka shënuar progres të theksuar duke e ngritur grupin e qytetarëve që besojnë në institucionin tonë nga 38% në 45% apo një progres prej 18% krahasuar me vitin paraprak, e cila reflekton rezultat të punës dhe qëndrimit tuaj profesional karshi publikut, qoftë në kontakte të drejtpërdrejta, qoftë në publikimet që bënë zyra për informim.

Sipas të gjeturave të raportit të progresit, Dogana vlerësohet të këtë zhvillime pozitive në fushën e luftimit të krimit të organizuar, parandalimit të ekonomisë joformale, ndalesës së mallrave të falsifikuara, lehtësimit të tregtisë etj.

Një studim i Bankës Botërore për kohën e zhdoganimit ka gjetur se ka pasur përmirësim të dukshëm në kohën e zhdoganimit në import për 36% dhe në eksport prej 16% krahasuar me matjen paraprake. Ky është indikator shumë i rëndësishëm për tërheqjen e investitorëve të huaj dhe lehtësimin e qarkullimit të mallrave dhe personave.

Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditorit nuk ka pasur asnjë gjetje të kualifikuar, ndërsa që gjetjet minore janë të pakta në numër dhe të pa rëndësishme në mirëfunksionimin e Doganës së Kosovës.

Padyshim që ngjarja më e spikatur gjatë këtij viti është zhvilluar gjatë tri javëve të muajve Nentor dhe Dhjetor, në veri të vendit , si pasoj e organizimit të luftës hibride atje, dhe e përkrahur nga elementë keqdashës, kemi pasur të mbyllur dy vendkalimet kufitare PKK Jarinje dhe PKK Bërnjak, ndërsa që Pikë kalimi kufitar Jarinje ka qenë i bllokuar edhe për lëvizje të stafit, si pasojë e së cilës kanë ngecur pa u ndërruar kolegët tonë për një kohë relativisht të gjatë.

Përtej përpjekjeve tona për të përkrahur maksimalisht kolegët në fjalë, ne e dimë se kanë pasur vështirësi të theksuara, por qëndrimi i tyre stoik e patriotik ka përfaqësuar uniformën e shtetit si detyrë dhe obligim ligjor po ashtu edhe si shembull për masën e gjërë se si duhet të luftojmë për të mbrojtur kufirin dhe vlerat e përbashkëta shoqërore të ndërtaura me shumë mund e sakrificë , andaj pa asnjë dyshim vlerësojmë se ata janë zyrtarët doganor të këtij viti dhe në emrin tim dhe të gjithë juve prapë i përgëzoj për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm.

Të gjitha këto arritje janë arsye për të besuar se kemi vepruar në drejtimin e duhur dhe kemi potencialin, vullnetin dhe guximin që të bëjmë edhe më shumë për Doganën, vendin dhe për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Gjithashtu përpjekjet tona për të ndërtaur dhe avancuar një sistem modern, të sigurtë, profesional dhe kompaktibil vetëm se do të shtohen me qëllim të ofrimit të shërbimeve

cilësore për tregtinë legjitime, ndërsa do të jemi shumë të përkushtuar për luftimin e çdo dukurie negative e cila rrezikon interesat e vendit dhe qytetarëve tonë.

Sinqerisht i juaji,
Agron Llugaliu
Drejtor i Përgjithshëm

PËRMBAJTJA

1. MBLEDHJA E TË HYRAVE	8
2. LEHTËSIRAT PËR BIZNESE	11
3. ZHVILLIMI I SISTEMEVE DHE PROCEDURAVE	13
4. LEGJISLACIONI	15
5. ZBATIMIT I LIGJIT	16
6. AKCIZA	18
7. LUFTIMI I KORRUPSIONIT	19
8. BUXHETI DHE FINANCAT	20
9. OPERACIONET E VEÇANTA KUNDËR KONTRABANDIMIT	22
10. PARANDALIMI I KONTRABANDËS	24

1. MBLEDHJA E TË HYRAVE

Mbledhja e të hyrave gjatë vitit 2022 ka tejkaluar të gjitha parashikimet pasi rezultatet kanë arritur rekorde të cilat më parë nuk janë arritur që nga themelimi i doganës. Faktorët kyç që kanë sjellur rezultate janë të shpërndarë në disa aspekte siq janë: luftimi i informalitetit, vetëdijesimi dhe trajtimi i barabartë i bizneseve, reformimi i proceseve të punës, bashkëpunimi me agjencionet tjera etj.

1.1. Të hyrat

Përkundër politikave fiskale siç janë ndikimi i MSA-se, MTL me Turqinë dhe lirimet nga detyrimet për lëndën e parë për prodhuesit, edhe gjatë këtij viti kanë vazhduar aktivitetet operative dhe administruese ku janë arritur rezultate të jashtëzakonshme në mbledhjen e të hyrave për buxhetin e shtetit. Të hyrat e realizuara në periudhën Janar-Dhjetor 2022 kanë shënuar rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021.

Taksat sipas llojeve	Jan-Dhjetor 2022 në mil. €	Jan-Dhjetor 2021 në mil. €	Krahasimi %
Vlera e mallit ne import	5,603.40	4,649.55	+20.51%
Doganë	132,66	124,61	+6.46%
Akcize	517,26	501,29	+3.18%
TVSH	875,38	746,54	+17.25%
Të tjera	6,01	4,29	+40.09%
Total taksa	1,531.31	1,376.73	+11.22%

Tabela e inkasimit te taksave Janar-Dhjetor 2022/2021

Në vitin 2022 janë inkasuar rreth **1,531.31 mil.€**, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021, ku të hyra ishin **1,376.73 mil. €**, janë realizuar 11.22% apo rreth 154,58 mil.€ më shumë të hyra.

Në këtë vit është tejkaluar për 3.60 % projeksioni i të hyrave i vënë nga QRK për DK , ku planifikimi ishte 1,478 mil.€

Rritja e të hyrave kryesisht mund t'i atribuohet rritjes së vlerës së mallit në import, sidomos rritjes së vlerës importit të produkteve me akcizë, respektivisht mallrave strategjike (derivatet e naftës dhe produktet e duhanit,) si dhe ngritjes së performancës së punës së Doganës.

Në vitin 2022 vlera e mallit të importuar është 5,603.40 mil.€, apo krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi rritje të mallrave në import prej rreth 20.51%.

Importi i produkteve me akcizë, respektivisht mallrave strategjike (krahasimi Janar-Dhjetor 2022/2021):

Muaji	Jan-Dhjetor 2022	Jan-Dhjetor 2021	Krahasimi %
Derivatet e Naftës	436,63 mil.€	Taksa 404,10 mil.€	+8.04%
Cigare	281,65mil.€	Taksa 236,62 mil.€	+19.03%
Veturat	91,16 mil.€	Taksa 93,53 mil.€	-2.53%

Tabela e importit të mallrave strategjike- Taksat (naftë, cigare, vetura) Janar-Dhjetor 2022/2021¹

Nga këto tri produkte janë inkasuar rreth **809,44** mil.€ apo rreth **52.86%** e të hyrave të përgjithshme nga importi. Importi i veturave ka shënuar rënie në taksa duke marr parasysh se vlera e veturave të përdorura këtë vit është rritur shumë, ndërsa ka rënë numri i veturave të importuara. Gjithashtu kemi rënie edhe tek sasia e derivateve të naftës në - 7.32%

Fluksi i Zhdoganimeve - në periudhën Janar-Dhjetor 2022 janë proceduar gjithsejtë 437,757 Deklarata Doganore derisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë proceduar 449,264. Janë 11,507 deklarata doganore më pak apo -2.56% . Numri i Deklaratave Doganore në import (IM4, IM5, IM6, IM7, IM9) është 331,506 DUD-a, ndërsa në eksport 95,908 DUD-a.

Numri i deklaratave	Jan-Dhjetor 2022	Jan-Dhjetor2021	Krahasimi %
Import të gjitha regjimet	331,506	354,777	-6.56%
Eksport të gjitha regjimet	95,908	85,608	+12.03%
Importi i personave fizik-DU4	9,698	8,274	+17.21%
Akciza e Brendshme-ED4	645	605	+6.61%
Gjithsejtë deklarata	437,757	449,264	-2.56%

Tabela e deklaratave Janar-Dhjetor 2022/2021

Në periudhën Janar-Dhjetor 2022 dogana ka vazhduar aktivitetet në arritjen e objektivave si në kontrollin kufitar, mbledhjen e të hyrave, lehtësirat tregtare, po ashtu edhe në luftimin dhe parandalimin kontrabandës.

Në periudhën raportuese mbledhja e të hyrave ka qenë më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu të hyrat gjatë këtij viti kanë qenë mbi projeksionet e vitit 2022 të vëna nga Qeveria. Vlerësojmë se indikatorët kyç që kanë ndikuar në rritjen e të hyrave perveq rritjes së konsumit dhe rritjes së kostove të produkteve, përmes reformimit të proceseve të punës dhe mbikqyrjes është ngritur performanca e punës.

1.2 Eksporti

Gjatë vitit 2022 kemi një trend me rritje inkurajuese për zhvillimin e mirëqenies dhe zhvillimin ekonomik. Eksporti i produkteve kosovare edhe këtë vit ka shënuar rritje, por vetëm në aspektin e vlerës, ndërsa në sasi (peshë) të mallrave të eksportuara kemi rënie. Kjo rënie e eksportit në sasi është më e theksuar te produktet minerale, metalet bazë (giza dhe çeliku) si dhe tekstilet dhe artikujve prej tekstili.

Viti	2022	2021	Krahasimi %
Sasia mil.kg.	837,45	986,59	-15.11%
Vlera e eksportit	869,57 mil €	712,55 mil.€	+22.03%

Tabela e eksporti te rregullt EX1 (10 00) Janar-Dhjetor 2022/2021²

Pra këtë vit kemi eksporte në shumën prej 869,57 mil.€, apo rreth 22.03% me shumë se sa periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

2. LEHTËSIRAT PËR BIZNESE

Lirimet për lëndë të parë, burime të energjisë, pjesë rezervë, pajisje të teknologjisë së informacionit dhe makinerive prodhuese në këtë vit raportues kanë arritur shumën e taksave prej 151 mil.€, gjersa për periudhën e njëjtë të vitit 2021 ishte 141 mil.€, apo 6.96% më shumë. Gjithashtu **ndikimi i MSA** në periudhën Janar-Dhjetor 2022 në taksa ka qenë rreth 118 mil.€, krahasuar me vitin 2021 që ishte 97 mil.€, këtë vit ndikimi i MSA në taksa ka shënuar rritje prej 21.47%. ndikim tjetër në taksat e grumbulluara kishte gjatë këtij viti edhe marrëveshja për tregti të lirë me Turqinë e që në periudhën Janar-Dhjetor 2022 është në vlerë prej rreth 30,84 mil.€, krahasuar me vitin 2021 që ishte 20,74 mil.€ ka shënuar rritje prej 48.69%.

Llojet e lirimeve	Viti 2022 Taksat e liruara mil.€	Viti 2021 Taksat e liruara mil.€	Krahasimi %
Lirimet Pako Fiskale	151,06	141,22	+6.96%
MSA	118,10	97,22	+21.47%
MTL me Turqi	30,84	20,74	+48.69%
Total lirimet	300	259,18	+15.75%

Tabela e lirimeve nga taksat Janar-Dhjetor 2022/2021

Sipas marrëveshjeve ndërqeveritare, në vitin 2022 kemi filluar me zhdoganimin e plote të mallrave në Porto Romano dhe në Portin e Durrësit duke iu mundësuar bizneseve kursim në kohe dhe kosto me të ulët të shpenzimeve. Nga këto porte sipas trendit aktual të importit kemi 360000 dërgesa në vit ku të gjitha dërgesat zhdoganohen në të dyja portet, përveç dërgesave që kërkojnë ekzaminim e që janë rreth 6500 nga numri i gjithmbarshëm i dërgesave në import.

Është nënshkruar protokollin për njohjen e plumbçeve mes Doganës së RKS dhe Doganës së Republikës së Shqipërisë

Janë licencuar 2 operator të autorizuar ekonomik ku përmes licencimit numri i kontrolleve do të jete me i vogël dërgesa do të trajtohet me prioritet, operatori mund të kërkojë vend të veçante për kontroll dhe lehtësira tjera etj.

Dogana e Kosovës përmes sektorve të saj gjatë 2022, konform detyrave dhe përgjegjësisë të deleguar ka ushtruar aktivitetin e saj që ka të bëjnë me autorizim të subjekteve për procedura doganore të cilat parashihen me dispozitat ligjore në fuqi, si: autorizime, licenca importi ose prodhimi të produkteve të caktuar, OAE, aneksin II për lirim nga taksat për subjektet prodhuese, si dhe lirimet për burime të energjisë sipas vendimeve të QRK nr. 13/07 dhe 14/07 të vitit 2017. etj. Në vijim po i shpalosim të dhënat statistikore të cilat përfshijnë periudhën janar - dhjetor 2022.

- Autorizime të reja për depo doganore40

- Kërkesa për procedurën e përpunimit të brendshëm.....223
- Kërkesa për përpunim të jashtëm.....3
- Kërkesa gjatë muajit për PTH.....171
- Autorizim për DMA, DDMA dhe TMA/ Ndryshime.....93
- Licenca për prodhues dhe importues të pijeve alkoolike.....101
- Licenca për produkte duhani.....33
- Lirime për prodhues të burimeve të energjisë44
- Lirime nga ATK.....371
- Operator Ekonomik të Autorizuar02

3. ZHVILLIMI I SISTEMEVE DHE PROCEDURAVE

Gjatë vitit 2022 Dogana ka përmirësuar dhe avancuar sitemet duke tentuar që proceset e punës si brenda doganës poashtu edhe nga palët e interesit të jëne më të qasshme nga qytetarët dhe bizneset.

Gjatë vitit 2022 janë bërë zhvillime dhe përmirësime të mëdha në sistemin SIMS që menaxhon stafin brenda Doganës, gjithashtu ky sistem është pasuruar me module të reja si atë të trajnimeve, modulën e agjetëve doganor etj.

Aplikacioni Mobil eDogana gjatë këtij viti ka funksionuar pa asnjë problem. Kemi pranuar informata të shumta nga qytetarët rreth kontrabandës me mallra e te cilat ne shumicën e rasteve kabe rezultuar me gjetje ne teren

- Ka vijuar puna ne zhvillimin e sistemeve elektronike ku është bere shtrirja e Asycudas te zyrtaret e Inspektoratit ne kuadër te MINT me qellim te targetimit te rasteve për kontrolle nga MINT.
- Ka përfunduar azhurmini i rregullt vjetor i tarifës
- Është zhvilluar tutje Moduli i akcizave ECM si mekanizëm për menaxhimin, trajtimin e kërkesave për furnizimin me banderola
- Është zhvilluar tutje moduli SIMS ku për here te pare ka filluar vlerësimi i performances se stafit ne forme elektronike drejtpërdrejtë ne modul.
- Numri i testimeve nga ana e Laboratorit te Doganës është 1937 nga te cilat 568 bashkërisht me MINT, ku pas testimit 70 mostra kane rezultuar jo-konforme
- Laboratori Doganor është duke marrë pjesë në testin krahasimor (PT test) me rrjetin e laboratorëve doganor European
-

Derisa edhe në aspektin e trenimit të stafit janë organizuar një mori trajnime ashtu që stafi ynë të ketë njohurit e nevojshme, vlen të theksohet

- Bashkëpunim me projektin EXBS ka vazhduar edhe këtë vit. Janë 2 Aktivitete trajnuese me gjithsej 16 oficer të trajnuar. Ndërsa në kuadër të takimeve regjionale të orgnaizuara nga EXBS, Dogana e Kosovës ka marrë pjesë në 3 takime me pjesëmarrje të shteteve të Ballkanit Perndimor.
- Në bashkëpunim me AKSP e Policinë e Kosovës janë zhvilluar 8 aktivitete trajnuese me gjithsej 63 zyrtar të trajnuar.
- Në bashkëpunim me Sektorin e DPI, kemi organizuar katër trajnime për **“E Drejta e Pronësisë Intellektuale”** me 54 zyrtar të trajnuar, zhvilluar nga ekspertët e IBF brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
- Nga CEPOL për Drejtorinë e Zbatimit të Ligjit janë organizuar katër aktivitete trajnuese (nje ka gene Webinar), me 14 OD të trajnuar.
- Në bashkëpunim me IKAP janë organizuar 19 aktivitete trajnuese me 45 OD të trajnuar.

- Nga UNDOC janë organizuar 2 aktivitete trajnuese me gjithsejtë 20 OD të trajnuar.
- Në bashkëpunim me SLDP është organizuar puntoria: Balkans Regional Customs and Judicial Joint Workshop, September 2022 CLDP, me 5 OD të trajnuar.
- Nga IBF/EU, janë organizuar katër aktivitete trajnuese me 56 të trajnuar në lidhje me DPI.
- Për nevojë të njëjësive organizative dhe të OD, përpilimi i raporteve individuale të trajnimit.
- Mbështetja e sektorit të personelit në përpilimin e raporteve individuale të trajnimit për oficerët doganor.

Organizata Botërore e Doganave

- Përgjatë vitit 2022 në kuadër të OBD janë mbajtur 26 aktivitete me gjithsej 56 pjesëmarrës nga sektorë të ndryshëm, ndërsa që kemi qenë të përfshirë edhe në disa operacione rajonale dhe botërore, në takimin e Këshillit, Takimin e Kyoto-s, ndërsa takimi i Rajonit të Evropës është anuluar për shkak të situatës në Ukrainë.
- Janë mbajtur 2 takime në OBD, me Sekretarin e Përgjithshëm dhe me Drejtorinë e Drejtorisë për Tarifë dhe tregti, si dhe takimi me DP e TAXUD dhe me DP e Doganës Belge (raporti detal i këtyre takimeve është dërguar tek Drejtorit të Kabinetit dhe DP).
- Është konfirmuar Koordinatori Nacional për AEO i cili do të plotësoj edhe hulumtimin për AEO në nivel nacional.
- Janë konfirmuar 2 zyrtar nga DK për të marr pjesë në takimin e-ATA/ Konventa e Stambollit, si dhe janë draftuar rekomandimet që BN i ka ofruar DP-se, për aderim në këtë Konventë.
- Është dërguar një nominues për procesin e përzgjedhjes së ekspertit në çështje gjinore në OBD.
- Gjithashtu në kuadër të programit CCP (UNODC dhe OBD), është mbajtur trajnimi 4 ditor për presuktor të drogave në Prishtinë.

Programi - Customs 2020

- Janë mbajtur 4 aktivitete në kuadër të Customs, përfshirë takimin e parë fizik në Bruksel.
- Kemi pranuar njoftimin që Komisioni Evropian ka përcjellë në kopje fizike marrëveshjen për programin Customs tek MFPT.
- Me kërkesë të udhëheqësit të projekti të asistencës, kemi mbajtur takim për çështjen e procedurave ratifikuese/dekretuese të Marrëveshjes së re.
- Kemi pranuar ftesë nga TAXUD për pjesëmarrje në takimin e Customs, ku ndër të tjera takimi është ftuar për shtetet pjesëmarrëse të reja në program. Ky takim ishte mundësi e mirë pas pranimit të Kosovës në këtë program.
- Paralelisht në periudhën e këtij takimi kemi marr pjesë edhe në takimin për CUP TAXUD
- Më 24-25 tetor kemi marr pjesë në takimin e Newcomers të Programit Customs dhe Fiscalis.
- Është mbajtur takimi i Koordinatorëve Nacional të programit në Qipro.
- Kemi përgatitur gjithë dosjen (akt emërimin e DP, Kodin Doganor, numrin fiskal dhe dokumente tjera ligjore të DK) për krijimin e numrit PIC për qasje në grante të Programi dhe jemi në proces të validimit nga EU .

4. LEGJISLACIONI

Në mënyrë aktive gjate këtij viti raportues zyrtaret nga Departamenti Ligjor kane qene të kyçur ne draftimin e projektligjit për Kodin e ri Doganor dhe te Akcizave i cili ka kaluar fazën e konsultimeve publike dhe sipas planit legjislativ te QRK-se pritet te miratohet në tremujorin e parë të 2023

Derisa departamenti ligjor (DL) gjate vitit 2022 ne zbatim te planit strategjik dhe atij te veprimit, ne kuadër te kompetencave ligjore dhe detyrave qe rrjedhin nga përskrimet e vendeve te punës ka treguar një performancë te kënaqshme duke filluar nga trajtimi i ankesave te subjekteve ndaj vendimeve te DK-se, dhënien e opinionëve ligjore, draftimin e akteve e ndryshme ligjore, zbatimin e planit legjislativ (PL) te QRK-se dhe te DK-se për vitin 2022, si dhe përfaqësimin e DK-se ne konteste te ndryshme administrative, civile, penale etj.

Gjatë vitit 2022 në **Sektorin për Rishqyrtimin e Vendimeve (SRV)** janë pranuar gjithsejtë **914** kërkesa të rregullta për rishqyrtim dhe **93** kërkesa të kthyer në rivendosje nga Gjykata Komerciale, apo ne total **1007** lëndë. Në raport me vitin 2021 kemi rritje të numrit të ankesave të rregullta prej **109** kërkesave, qe reflektohet me kontest të vlerës, deri sa kemi **105** lëndë me pak te kthyer ne rivendosje nga Gjykata themelore.

Lëndë/kërkesa te rregullta te përfunduara janë **990** dhe **119** lëndë te kthyer ne rivendosje nga Gjykata, apo ne total te përfunduara **1109** lende, qe ne krahasim me vitin e kaluar është një rritje e konsiderueshme prej **202** lende me shumë të zgjidhura.

Në procedurë kanë mbetur **57** lëndë të rregullta dhe **1** lëndë e kthyer në rivendosje nga Gjykata, apo në total **58** lëndë të bartura në vitin 2023, që në krahasim me vitin paraprak janë 98 lëndë më pak në procedurë.

Situatë identike me vitin paraprak ku dominojnë ankesat për rivlerësim te mallrave, të cilat përfaqësojnë mbi 70% të kërkesave të përgjithshme, deri sa po ashtu lëndë të refuzuara janë mbi 75% nga totali i atyre të përfunduara.

<u>Lloji i kerkeses</u>	<u>Kërkesa per rishqyrtime (te rregullta)</u>		<u>Lende ne rivendosje nga Gjykata</u>	
	2022	2021	2022	2021
Te pranuar	914	805	93	196
Te përfunduara (zgjidhur)	990	788	119	198
Ne procedurë	57	129	1	27
<u>Mënyra e vendosjes</u>	<u>Te rregullta</u>		<u>Lende nga Gjykatat</u>	
	2022	2021	2022	2021
Aprovim	106	63	22	34
Aprovim pjesëshëm	78	39	9	14
Refuzim	737	619	88	143
Te tjera	69	68	0	7
<u>Lloji i kontestit</u>	<u>Te rregullta SRV</u>		<u>Lende nga Gjykatat</u>	
	2022	2021		2022
Vlerësim	693	555	96	164
Kundërvajtje doganore	168	112	13	12
Të tjera	129	121	10	22

Dogana në strategjinë saj inkurajon rritjen e këshillave ligjore ashtu që kompanitë, bizneset dhe qytetaret të jenë të informuar saktë me legjislacionin në fuqi. Gjate vitit 2022 janë dhënë 423 këshilla ligjore për subjektet e ndryshme, palët fizike, institucione shtetërore etj.

Zyrtarë ligjor të Doganës kanë marre pjese ne 538 seanca te ndryshme ne Gjykatat e të gjitha niveleve dhe kompetencave te ndryshme si dhe janë parashtruar 88 ankesa ne Gjykatën e Apelit , ndërsa 9 të tjera në Gjykatën Supreme.

Tek përmbaruesi janë dërguar 160 lëndë në vlerë prej 887,905.94 €, nga të cilat janë inkasuar 92,606.63 €, deri sa bazuar në vendime të Gjykatave janë kthyer 562,928.

Gjate vitit raportues janë pranuar 227 aktgjykime nga Gjykata themelore me të cilat janë refuzuar padite subjekteve, deri sa ne 32 raste ato janë aprovuar.

5. ZBATIMIT I LIGJIT

Në fushën e aktiviteteve të zbatimit të ligjit, Dogana e Kosovës me qellim së arritjes objektivave në fushën e pranadalimit të kontrabandës si dhe dukurive tjera negative ka ndërmar një mori aksionesh të cilat kanë qëllim ofrimin e një ambienti të barabart biznesi dhe rritjen e gjithmbarshme në zingjrin e sigurisë së vendit.

Nga te gjitha njësitet e Doganes janë kryer 11157 kontrolla: ndalesa rrugore, kontrolla neper pikekalime, kontrolla te subjektet etj.

Njësitet Antikontrabande kane qene pjesëmarrës ne **92** Plane Operative me Agjencione te tjera te Zbatimit te ligjit.

Sektori per kundervatje doganore ka trajtuar 1832 kundervatje te zbuluara ku janë konfiskuar mallra në vlere prej **rreth 11.3 milion € per shkelje te ndryshme doganores si:** kontrabandë, mallra qe shkelin te drejtën e pronesisë intelektuale etj.

	2021	2022	Diferenca
Aktivitetet e kontrollave	10166	11157	+9.7 %
Plane Operative me Agjencione te tjera	76	92	+ 21.05 %
Kundërvajtje te rregullta	1774	1832	+3.3 %
Vlera e mallit konfiskuar (sipas kundervajtjeve dhe mallra falso)	9.9 mil.€	11.3 mil.€	+ 24.31 %
Gjobat sipas kundervajtjeve	1.366 mil.€	1.852 mil.€	+35.58%

Sektori Kontrolle Pas Importit ka realizuar **156** Kontrolle të rregullta dhe pa paralajmërim. Ka lëshuar **100** aktvendime për Inkasim ne vlere prej **4,698,218.36 Euro**.

	2021	2022	Diferenca
Numri i Kontrollave	191	156	-18.32 %
Numri i Aktvendimeve	126	100	-20.63 %
Vlera e Aktvendimeve per Inkasim	3,361,650.63 €	4,698,218.36 €	+ 39.75 %

Derisa në kuadër të së Drejtës për Pronësi Intelektuale, Dogana ka verifikuar **612 raste**, ku janë ndaluar për verifikim **968,980** artikuj dhe është konfiskuar mall i falsifikuar në vlerë prej **8,757,724.00 Euro**. Janë asgjësuar **212,253 Artikuj** ne vlere prej **7,271,912.00 Euro**.

Dogana përmes hetimeve ka regjistruar **91 raste** te reja per Hetim, dhe i ka dorëzuar **69 Kallëzime Penale** pranë prokurorive përgjegjëse ku janë siguruar prova te mjaftueshme që dëshmojnë shmangie nga detyrimet doganore ne vlere prej **2,873,093.20 €**, ndërsa janë

sekustruar mallra në vlerë prej **1,868,951.67 Euro**. Për kontrabandim dhe shmangie nga tatimet e detyrueshme nga hetuesia doganore janë intervistuar **201 persona** të dyshuar, dhe janë arrestuar **16 Persona**.

- Parandalimi i ekonomioise joformale i argumentuar është ne lartesi prej 4.5mln€ është Kjo eshet konstatuar vetem te pjesa e lirimeve nga taksat akcizore për derivate të importuara për qëllime prodhimi apo për qëllime përdorimi nga personat diplomatik/përfaqësite diplomatike dhe rastet jane proceduar penalisht ne Prokurorite pergjegjese.
- Bazuar ne planin operativ për kontroll te mallrave te ashtuquajtura ‘mall i autobusëve’ janë ndërmarrë 125 aktivitete te kontrollit te mallrave nga Turqia, ku ne 60 raste te ndryshme janë zbuluar parregullsi për mallra ne vlere prej afro 490,000.00€ e të cilat konsistojnë ne shkelje te ndryshme si: mall i padeklaruar, deklarata e pasakte, mallra që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale etj.
- Kundër pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizimit Dogana e Kosovës ka trajtuar 6 raste për pastrim te parave gjithnjë ne bashkëpunim me Prokurorinë Speciale. Si rezultat, Gjykata Themelore e Prishtinës ka shpallur fajtor 2 persona për 2 raste te ndara, për veprën penale “Shpëlarja e parave”

Zbulimi i mallrave te ndaluara

Dogana e Kosoves këtë vit ka treguar rezultate të medha edhe te **zbulimi i mallrave të ndaluara** të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në taksa por efekti në mbrojtjen e shoqërisë është shumë i lartë, ku me veprimet e zyrtareve të Doganes janë zbuluar 83.6 kg substancë narkotike Heroinë, dhe si rezultat i informatës së Doganes së Kosoves, në Turqi jane ndaluar 108 kg narkotik Heroine të cilat dyshohet se kanë pasur destinacion Kosovën. Te aktivitetet e përbashketa me policinë jane zbuluar 10,000 bime narkotike në vlere prej rreth 6 mln € dhe laboratorit në vlere prej afro 1.5 mln€, ndërkaq gjatë kontrollit të një dërgese me mallra ne import jane zbuluar 70 kg narkotik. Rastet e parandalimit apo daljes në treg të armëve të ftohta në sasi prej 116 cope (dylbi, thika boksa etj), antiminera 369 cope, kartela grafike në sasi prej 607 copë etj janë disa nga aktivitetet e Doganes në drejtim te ndaljes se dukurive te negative dhe mbrojtjes së shoqërisë.

	2021	2022	Diferenca
Raste te reja nen Hetime	96	91	-5.20 %
Kallëzime Penale	84	69	-18.82 %
Vlera e Shmangieve te argumentuara	2,714,962.41 €	2,873,093.20 €	+ 5.82 %
Vlera e mallit te Sekuestruar	1,376,181.59 €	1,868,951.67 €	+ 35.80 %
Numri i Personave te Intervistuar	136	201	+ 47.79 %
Numri i personave te Arrestuar	13	16	+ 23.07 %

6 AKCIZA

Produktet me akcizë janë produkte që trajtohen me vëmendje të veçantë nga Dogana e Kosovës. Ato përbëjnë angazhim dhe profesionalizëm të veçantë pasi që vlera tatimore e tyre është e lartë. Gjatë vitit 2022 dogana ka shtuar mbikëqyrjen në fushën e importit dhe prodhimit të mallrave akcizore si: duhanit dhe produkteve të tij, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, menaxhimit të banderolave të duhanit dhe produkteve të tij, menaxhimit të banderolave të pijeve alkoolike të importuara dhe ato të prodhuara brenda vendit, mbikëqyrjen e burimeve të energjisë të liruara sipas vendimit të Qeverisë.

Te hyrat nga produktet akcizore	2022	2021
Pijet alkoolike	5,374,830.56 €	5,208,185.63 €
Pijet joalkoolike	651,844.69 €	665,832.39 €
Akciza e brendshme - Cigare	369,655.70 €	256,202.00€
Akciza importi i duhanit	213,826,528.40€	180,060,975,95 €

Te hyrat nga produktet akcizore krahasim 2021/2022

Sipas raporteve krahasuese vërehet rritje sasisë se importit të cigareve dhe shumës së taksës se inkasuar të cilat janë paraqitur në tabelë dhe grafike si në vijim;

Muaji	2021			Neto (t)	2022	
	Neto (t)	MIL	Akciza		MIL	Akciza
Janar	252.27	270,187.20	13,235,488.00 €	255.54	266,320.10	13,572,107.50 €
Shkurt	233.66	246,934.50	12,086,957.80 €	243.54	263,761.65	13,414,652.10 €
Mars	235.60	246,532.12	12,073,238.40 €	290.21	316,914.74	16,157,369.60 €
Prill	269.34	287,697.08	14,097,373.35 €	279.90	294,411.80	15,014,369.20 €
Maj	243.44	264,086.00	12,910,240.20 €	278.86	285,390.94	14,539,949.40 €
Qershor	299.95	308,900.27	15,132,690.90 €	349.07	368,032.61	18,726,472.90 €
Korrik	365.66	388,657.18	19,018,017.90 €	430.26	454,731.15	23,181,167.70 €
Gusht	354.06	370,816.44	17,328,120.00 €	421.10	460,448.40	23,387,638.20 €
Shtator	387.74	417,728.37	20,440,153.20 €	457.96	488,600.91	24,904,344.10 €
Tetor	234.18	245,250.82	12,012,850.00 €	247.80	259,805.63	13,244,593.10 €
Nentor	285.16	306,185.31	15,002,336.50 €	310.91	329,914.77	16,807,188.60 €
Dhjetor	333.96	341,479.16	16,723,509.00 €	402.64	409,819.88	20,876,676.00 €
Totali	3,495.02	3,694,454.45	180,060,975.25 €	3,967.79	4,198,152.58	213,826,528.40 €

Importi dhe taksat nga importi i duhani sipas muajve krahasim 2021/2022

7. LUFTIMI I KORRUPSIONIT

Dogana e Kosovës përmes Sektorit për Standarde Profesionale sigurohet që të gjithë zyrtarët e doganës gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare të jenë në nivelin më të lartë të përgjegjësisë dhe që veprimet e tyre të jenë në përputhje me Kodin e Sjelljes. Dogana e Kosovës përmes këtij sektori monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e drejtë të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera në fuqi nga të gjitha nivelet ato lokale dhe qendrore. Bashkëpunimi i SSP shtrihet në të gjitha njësitë organizative, duke marrë masa parandaluese dhe hetimore të shkeljeve disiplinore në përputhje me ligjin dhe rregullat e brendshme të Doganës së Kosovës dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit të DK-së.

Gjatë vitit 2022, janë realizuar këto aktivitete:

- Raste disiplinore të iniciuara gjatë periudhës raportuese 12;
- Raste të përfunduara (duke përfshirë rastet të bartura) 19;
- Raste të përfunduara në nivel lokal 2;
- Raste të mbyllura 2;
- Raste të referuara në Komision Disiplinor 15;
- Raste në proces të hetimit 3;
- Informata të pranuar 14;
- Informata në proces të trajtimit 1;
- Intervista 73;

Masa disiplinore të shqiptuara:

- Dënime financiare 12
- Përfundim nga puna 12;
- Vërejtje me shkrim 1;
- Suspendime: 4 zyrtarë doganor

Gjatë vitit 2022 është punuar në realizimin e hetimeve të informatave të pranuar, po ashtu të rasteve disiplinore duke kryer të gjitha analizat e dokumentacionit, regjistrave, dhe raporteve me qëllim të përgatitjes së rasteve për t'u shqyrtuar qoftë nga Komisioni Disiplinor apo në nivel lokal.

Gjatë vitit 2022 janë realizuar **42** inspektime në ZBD, PKK dhe sektor të ndryshëm . Kryesisht natyra e inspektimeve ka të bëjë me zbatimin e drejtë të orarit të punës dhe disiplinës së stafit në punë, identifikimi i mangësive në sistem, përbëjnë një veprim operativ me shumë rëndësi për të parandaluar dhe raportuar shkeljet procedurale dhe ato të punës.

8. BUXHETI DHE FINANCAT

Në bazë të Ligjit nr. 08/L-066 - Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Doganës i janë ndare buxhet sipas kategorisë së shpenzimeve të paraqitura në tabelën në vijim. Në muajin shkurt me 14.02.2022 në buxhetin e DK-së janë bartur /alokuar nga MFPT mjetet në shumë prej **6,000.00 €** nga viti 2021 donacion nga EU-Unioni European për shpenzimet e anëtarësimit në CUSTOMS 2020. Mjetet të cilat kanë pësuar implikim buxhetore të rritur nga buxheti i aprovuar për këtë vit .Buxheti final vjetor në bazë të raportit të Fre Balancit të datës 10.01.2022 është zvogëluar buxheti sipas kursimeve të paraqitura në këtë muaj për kategorinë mallra shërbime 47,000.00, komunal 104,845.29

<i>Kategoritë e shpenzimeve</i>	<i>Buxheti i aprovuar sipas ligjit Nr. 07/L-041</i>	<i>Buxhetit i aprovuar</i>	<i>Buxhetit i aprovuar sipas ligj</i>	<i>Buxheti i aprovuar nëntor 2021</i>	<i>Buxheti sipas shkurtimeve</i>	<i>Buxheti final</i>
<i>Nr. lejuar</i>	581	581	581	581	581	581
<i>Paga dhe Mëditje</i>	6,417,127.00	6,491,127.41	6,526,127.00	6,526,127.42	6,526,127.42	5,815,101.06
<i>Mallra dhe Shërbim</i>	2,055,086.00	2,055,086.00	2,185,086.00	2,144,086.00	2,144,086.00	2,098,749.00
<i>Shpenzime Komunale</i>	169,375.00	169,375.00	169,375.00	169,375.00	169,375.00	64,529.71
<i>Shpenzimet Kapitale</i>	1,700,000.00	1,700,000.00	2,200,000.00	2,200,000.00	1,872,430.02	1,872,430.02
<i>Totali</i>	10,341,588.00	10,415,588.41	11,080,588.00	11,039,588.42	10,712,018.44	9,850,809.79

Shpenzimet buxhetore të Doganës së Kosovës

Spektori i prokurimit gjatë vitit 2022 ka kryer punët që janë në fushëveprimin e këtij sektori të përcaktuara me LPP dhe UA për shitje të mallrave të konfiskuara. Gjate këtij viti angazhimi i sektorit ka qenë kryesisht i orientuar në përgatitjen e procedurave të tenderëve dhe kontratave. Gjithsej janë publikuar **109** ankande të shitjes. Totali i të hyrave të realizuara nga shitjet e mallrave të konfiskuara është: **325,365.85 €**. Totali i të hyrave të realizuara nga shitjet e aseteve është: **32,263.20 €**

9. OPERACIONET E VEÇANTA KUNDËR KONTRABANDËS

Gjatë këtij viti Dogana e Kosovës ka kryer një numër të konsiderueshëm të aksioneve të suksesshme dhe ka arritur rezultate të knaqshme. Raste e zbulimeve të Doganës gjatë vitit 2022 ishin si në vijim:

Gjate këtij viti DZL ka kryer një numër të aksioneve të suksesshme dhe ka arritur rezultate, disa prej të cilave janë si në vijim:

- Me 08 Janar 2022 DK e përkrahur nga Policia e Kosovës ka organizuar kontroll në Leposavic ku janë sekuestruar mallra të kontrabanduara (272 Antminera për prodhim të Bitcoinave) në vlerë prej 56,010.00 Euro.
- Me 25 Janar 2022 Dogana e Kosovës në magjistralen Peje – Prishtinë ka organizuar ndalesa rrugore dhe në një Automjet ka arritur të gjeje një armë të fshehur e tipit Ekol Magnum.
- Me 02 Shkurt 2022 Dogana e Kosovës me autorizim të Prokurorisë Themelore në Prizren, pas hetimit disa mujor ka kryer kontrole në 7 lokacione të ndryshme në Prizren për mallra të kontrabanduara. Me këtë rast është gjetur mall i ndryshëm (Telefona celular, Pjese rezerve për Telefona dhe Aksesore për Telefona) pa origjinë / dokumentacion përcjellës i cili dyshohet se është kontrabanduar me vlerë prej 72,179.26 Euro. Shmangiet nga Detyrimet Doganor janë 21,509.41 Euro.
- Me 07 Shkurt 2022 në regionin e Mitrovicës, njësitet Antikontrabandes të Doganës së Kosovës kanë arritur të identifikojnë dhe ndalojnë dy automjete të dyshuara që përdorën nga kontrabandistë për kontrabandë të mallrave. Në këtë rast është hasur në mallra të kontrabanduar: Vaj Motorik 1600 Litra dhe Material Elektrik 3000 cope Priza, Ndërprerës dhe Fyta për Poqa elektrik.
- Me 09 Shkurt 2022 në magjistralen Aeroport – Prishtinë, Njësitet Antikontrabande kanë arritur të identifikojnë dhe ndalojnë një automjet transportues të dyshimtë. Me këtë rast janë gjetur cigare të Kontrabanduara / pa dokumentacion përcjellës në sasi prej 1,000,000 Cope Cigare (100 Pako x50x20x10), në vlerë prej 12,000.00 €. Shmangiet nga Detyrimet Doganore llogaritet të jenë 63,756.00 €.
- Me 21 Shkurt 2022 Njësitet Antikontrabande kanë organizuar kontrole në tri Barnatore në Qytetin e Prishtinës. Me këtë rast është hasur në 482 Artikuj të ndryshëm (482 lloje të Barnave) të kontrabanduar / pa dokumentacion përcjellës, me vlerë rreth 10,000.00 Euro.

- Me 01 Mars 2022 ne regjionin e Mitrovicës, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne bashkëpunim me Policinë e Kosovës kane arritur te identifikojnë dhe ndalojnë një Automjet Transportues te dyshimte I cili transportonte 2050 litra Pije Joalkoolike te Kontrabanduara përmes Mitrovicës se Veriut. (Multisola 450 litra, Fanta 320 litra, Coca Cola 1280 litra)
- Me 18 Mars 2022 në regjionin e Prishtinës / Magjistrale Prishtinë - Podujevë, Njësitet Antikontrabande kane arritur te Identifikojnë dhe ndalojnë një Automjet transportues i cili barte mjete piroteknike / Fishekzjarre te Kontrabanduara. Vlera e mallit 4,952.00 Euro dhe Taksat e Shmangura me këtë rast janë 9,396.00 Euro
- Me 15 Prill 2022 ne Kaçanik Dogana e Kosovës ka realizuar një Kontrolle ndaj në subjekti afarist të dyshimtë, dhe me këtë rast është hasur në tekstil pa dokumentacion dhe i Kontrabanduar me vlere prej 98,948.00 Euro.
- Me 21 Prill 2022 ne Drenas, Njësitet Antikontrabande kanë arritur të identifikojnë dhe ndalojnë një automjet i cili ishte duke transportuar 13,440 litra Alkool koncentrat 96% Etanol me vlere prej 23,923.20 €. Shmangiet nga Detyrimet Doganore te llogaritura per këtë rast janë 83,253.27 Euro.
- Me 05 Maj 2022 Dogana e Kosovës ka organizuar një kontrolle në disa barnatore në disa lokacione (Graçanice, Ranillug dhe Shterpce), ku me këtë rast është hasur ne një sasi te konsiderueshme të barnave të kontrabanduara nga Serbia.
- Me 23 Maj 2022 ne Zveqan / Mitrovicë Veriore, Dogana e Kosovës e përkrahur nga Policia e Kosovës ka organizuar një kontroll tek një subjekt nën dyshimin për prezencë të mallrave të kontrabanduara. Me këtë rast është hasur ne një Laborator per kultivimin e bimëve narkotike dhe janë zbuluar rreth 10,000 bime narkotike. Ky rast sipas procedurës i është dorëzuar Policisë se Kosovës / Drejtorisë per Hetime te Narkotikeve. Sipas vlerësimit të Policisë, vlera e bimëve narkotike është rreth 6 milion Euro, kurse e laboratorit mbi 1,5 Milion Euro.
- Me 06 Qershor 2022, ne magjistralen Mitrovicë - Prishtinë, Njësitet Antikontrabandës kane arritur te identifikojnë dhe ndalojnë 3 Automjete transportuese te cilat ishin duke transportuar peme dhe lule te freskëta te kontrabanduara nga Serbia. Me këtë rast janë sekuestruar 2200 kg Qersh, Pjeshke, Nektarin dhe Lule te freskëta.
- Më 22 Qershor 2022, ne Veri te Mitrovicës / Fshati Zherovnice Njësitet Antikontrabandës gjate patrullimit kane arritur te identifikojnë një automjet transportues të dyshimte. Fillimisht Automjeti i dyshuar nuk është ndaluar dhe ka

ikur por fal angazhimit dhe profesionalizmit të Njësiteve të Antikontrabandës të Doganës së Kosovës automjetin kanë arritur ta ndalojnë, dhe të vërtetohet se ishte duke transportuar mallra të kontrabanduara (900 litra Pije Alkoolike dhe joalkoolike). Me këtë rast rrugës në hyrje të Zveqanit gjatë dërgimit të automjetit me mallra në Terminalin Doganor në Pjesën Jugore të Mitrovicës tri automjete tjera kanë penguar dhe kanë tentuar që të bllokojnë Zyrtaret e Doganës në kryerjen e detyrës zyrtare. Mirëpo fal përkushtimit dhe profesionalizmit të Zyrtareve Doganor është arritur që të evitohen këto pengesa dhe automjeti i dyshimte me mallra të kontrabanduara të dërgohet në mbikëqyrje doganore në Terminal.

- Me 29 Qershor 2022 Njësitet Antikontrabandës të Doganës së Kosovës në bashkëpunim dhe përkrahje të Policisë së Kosovës kanë identifikuar një automjet transportues të dyshuar i cili rrugëtonte nga Mitrovica e Veriut. Njësitet e Doganës dhe ato të Policisë kanë arritur që ta ndalojnë automjetin në Malisheve. Me këtë rast është hasur në malle të kontrabanduara me origjinë nga Serbia / Alkool Etilik 96% në sasi prej 2400 litra. Vlera e mallit vlerësohet të jetë 4300 Euro, kurse shmangiet ndaj Detyrimit Doganor janë në vlerë prej 14,300.00 Euro.
- Me 07 korrik /2022 në Regjion të Mitrovicës, Njësitet Antikontrabandës në kuadër të Planit Operativ të organizuar kanë arritur në 4 raste të ndara të identifikojnë dhe ndalojnë 4 automjete transportuese me mallra të Kontrabanduara nga Serbia e që vinin nga Mitrovica e Veriut.
 1. Në Automjetin e parë është hasur në 1200 litra Pije Joalkoolike Coca Cola, 105 litra Vaj Ushqimor dhe 144 litra Tretës/Nitro Solvent.
 2. Në Automjetin e dytë është hasur në 1470 litra Pije Joalkoolike Multisola dhe 60 cope Çokollatë Milka.
 3. Në Automjetin e tretë është hasur në 2329 litra Pije Joalkoolike Coca Cola
 4. Në Automjetin e katërt është hasur në 900 litra Tretës/Nitro Solvent.
- Me 10 Gusht 2022, në PKK Vermice, Njësitet Antikontrabandës kanë selektuar për kontrollë të vijës së dytë një Autobus të linjës Tirane-Prishtinë dhe me këtë rast është hasur në mallra të padeklaruar si në vijim:
 1. Injeksione REVOLAX DEEP / LIDOCAINE – 60 pce
 2. REVOLAX SUB-Q / LIDOCAINE – 60 pce
 3. REVOLAX FINE / LIDOCAINE – 5 pce
 4. Tableta Dezinfektuese të Chlorit “Diversity Suma Tab 1x300 – 16 pako x 300 tableta
 5. Xhama me dioptri të ndryshëm sasia totale 17 pale

- Me 24 Gusht 2022 ne Podujeve, Oficeret Doganor me urdhër te Organeve Kompetente kane kryer një bastisje ne një banesë private me te cilin rast është gjetur mall pa dokumentacion e i cili është kontrabanduar ne Kosove.

Me ketë rast janë konfiskuar:

1. 23 cope Ant-Miner El 3 dhe
 2. 13 shtëpiza 1 st cool
- Me 26 Gusht 2022 ne magjistralen Prishtine - Mitrovice, Njësitet Antikontrabande te Doganës se Kosovës ne bashkëpunim me Policinë e Kosovës kane identifikuar nje Automjet Transportues te dyshimte, i cili ishte duke transportuar 250,000 cope Cigare pa banderola e te kontrabanduara në Kosovë. Shmangiet e llogaritura nga Taksat e aplikueshme janë 15,885.00 Euro.
 - Me 04 tetor 2022 pas një Hetimi disa mujor Zyrtaret e Sektorit te Hetuesisë te Doganës se Kosovës të udhëhequr nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, kane arrestuar dhe dërguar ne mbajtje një person te dyshuar per kryerje te veprave Penale si ne vijim:
 1. Falsifikim i Dokumenteve,
 2. Mashtrim, dhe
 3. Shmangie nga Taksat e Detyrueshme Doganore,

I dyshuari ne mënyre te përsëritur ka Falsifikuar Dokumente per Automjete me qellim te Shmangies nga Taksat e Detyrueshme Doganore, dhe si rrjedhoje e këtij veprimi dëmi i shkaktuar llogaritet te jetë mbi 500,000.00 Euro.

- Me 14 tetor 2022 ne PKK hani i Elezit, pas një hetimi disa mujor Sektori i Hetuesisë me autorizim te Prokurorisë ka arrestuar një zyrtar Doganor per keqpërdorim te detyrës zyrtare dhe 4 te dyshuar per Kontrabandim dhe dhënie ryshfeti.
- Me 25 tetor 2022 Njësitet Antikontrabande kane parandaluar një rast te kontrabandimit te mallrave me origjine nga Turqia. Mallrat ishin të fshehura ne një kamion.

Mallrat e zbuluara:

1. Auto pjesë
2. Produkte Farmaceutike / Barna
3. Produkte Stimuluese Seksuale te ndryshme

Vlera e këtij malli llogaritet te jete 42,958.13€.

- Me 29 Tetor 2022, ne fshatin Leshak / Komuna e Leposaviqit, Njësitet Antikontrabandes të Doganës së Kosovës dhe Njësitet e Policisë se Kosovës me qellim

te Zbatimit te ligjit, luftimit te Kontrabandës dhe dukurive te tjera negative kanë organizuar një aksion te përbashkët dhe me këtë rast është hasur ne një objekt afarist ne te cilin kishte pajisje per prodhim te kriptovalutave dhe pije te ndryshme alkoolike dhe joalkoolike

Me këtë rast janë konfiskuar këto mallra te kontrabanduara:

1. 93 Kartela Grafike
 2. 8 Antminera
 3. 17 pllaka elektronike
 4. 17 power Supply
 5. 280 litra Birra
- Me 04 nëntor 2022 në regjionin e Prishtinës, Drejtorja e Zbatimit te ligjit pas veprimeve operative ka kryer një kontrollë ne një depo ku është hasur me mall te kontrabanduar pije Alkoolike në sasi prej 866 shisheve me vlere prej 25.000 Eurove.
 - Me 10 nëntor 2022 ne Mitrovice Njësitët e DZL-se kane kryer kontrollë tek një subjekt dhe me këtë rast është hasur mall i kontrabanduar si : 63 Kg Nargjile dhe 2400 cope Cigare Heets.
 - Me 24 nëntor 2022 në Hani i Elezit, Njësitët Antikontrabande kanë ushtruar kontrollin detal të një ngarkese te dyshimte, dhe me këtë rast është hasur një sasi e konsiderueshme e produkteve farmaceutike, te cilat vozitësi i kamionit i kishte fshehur ne hapësira te kamionit.
 - Me 06 dhjetor 2022 në Hoqë Komuna e Rahovecit, Drejtorja e Zbatimit te ligjit ka organizuar një kontrollë tek një subjekt i palicencuar per prodhim te pijeve alkoolike dhe me këtë rast me urdhër te organeve kompetente janë sekuestruar 25,186 Litra pije alkoolike. Shmangiet nga Taksat e aplikueshme/Akciza llogaritet të jenë 36,461.00 Euro.